

UDHËZIM
Nr. 1, datë 2.6.2021

PËR MËNYRËN E LLOGARITJES SË FIKSIT
TË KURSIT TË KËMBIMIT TË LEKUT NË BANKËN E SHQIPËRISË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat “b” dhe “c”, si dhe të neneve 59 dhe 60, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

UDHËZON:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i mënyrës së llogaritjes së fiksit për efekte të përfuturit të një niveli të vetëm reference të kursit të këmbimit të lekut ndaj monedhave të huaja, i cili më pas mund të përdoret nga të interesuarit për qëllime statistikore, krahasuese, kontabilizuese, vlerësuese dhe tregtuese.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllim të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- a) “Fiksi” – është kursi zyrtar i këmbimit i disa prej monedhave të huaja kundrejt lekut, që përfaqësohet nga një vlerë e vetme dhe publikohet nga Banka e Shqipërisë;
- b) “Mesatarja e çmimit në blerje (*bid price*)” – është mesatarja e thjeshtë aritmetike e çmimeve të kuotuar nga bankat, me të cilat ato janë të gatshme të blejnë një sasi të monedhës së huaj kundrejt lekut. Ajo llogaritet për kurset e blerjes së euros dhe për kurset e blerjes së dollarit amerikan;
- c) “Mesatarja e çmimit në shitje (*ask price*)” – është mesatarja e thjeshtë aritmetike e çmimeve të kuotuar nga bankat, me të cilat ato janë të gatshme të shesin një sasi të monedhës së huaj kundrejt lekut. Ajo llogaritet për kurset e shitjes së euros dhe për kurset e shitjes së dollarit amerikan;
- d) “DOM” – është Departamenti i Operacioneve Monetare në Bankën e Shqipërisë;
- e) “Pjesëmarrës” - janë ato banka, të përzgjedhura nga DOM-i, sipas nenit 3, pika 1, të këtij udhëzimi, të cilat ofrojnë kurset e këmbimit të blerjes dhe të shitjes së euros dhe dollarit amerikan kundrejt lekut, në bazë të të cilave llogaritet fiksi i euros dhe i dollarit amerikan kundrejt lekut;
- f) “Monedha e referencës” – është ajo monedhë, kursi fiks i së cilës llogaritet drejtpërdrejtë nga kuotimet e pjesëmarrësve në procesin e fiksit. Njëkohësisht, kursi fiks i kësaj monedhe shërben për llogaritjen e kursit fiks të këmbimit për monedha të tjera të përfshira në fiks;
- g) “Kuotimi standard” – është shfaqja e njëkohshme e çmimit në blerje dhe çmimit në shitje për shumën 100 mijë euro dhe 100 mijë dollarë amerikan nga pjesëmarrësi në fiks;
- h) “Banka” - është banka tregtare e licencuar sipas legjislacionit bankar.

Neni 3
Pjesëmarrësit

1. Pjesëmarrës në procesin e fiksimit janë 10 banka që operojnë brenda vendit dhe kanë vëllimin më të lartë të veprimeve në treg ndërbankar në 24 muajt e fundit. DOM-i rishikon listën e pjesëmarrësve në procesin e fiksimit, të paktën një herë në vit.

2. Banka e Shqipërisë publikon në faqen e saj zyrtare të internetit listën e bankave pjesëmarrëse në procesin e fiksimit dhe DOM-i njofton me shkrim secilën prej bankave pjesëmarrëse.

3. Banka e Shqipërisë, në rastet kur nuk siguron informacionin e kërkuar nga bankat të cilat janë pjesëmarrëse në procesin e përcaktimit të fiksimit, në përputhje me kriterin e pikës 1, e përcakton atë duke u bazuar në informacionin e marrë nga jo më pak se 5 banka.

4. Banka e Shqipërisë, në rast se nuk ka informacionin e kërkuar nga pjesëmarrësit në procesin e përcaktimit të fiksimit, në përputhje me pikat 1 dhe 3, përcakton kursin zyrtar të këmbimit të njëjtë me atë të ditës së punës paraardhëse.

Neni 4

Dhënia e informacionit nga bankat

1. Bankat i komunikojnë kuotimet standarde të dollarit amerikan dhe euros nëpërmjet faqeve të tyre në *Thomson Reuters Eikon*.

2. Nëse për arsye teknike një gjë e tillë është e pamundur, bankat i japin kurset e tyre jo të standardizuara nëpërmjet *Refinitiv FX TRADING*, *Bloomberg*, postës elektronike ose telefonit. Në rastet kur kurset e bankave merren me postë elektronike ose telefon, ato duhet të konfirmohen më pas në *Refinitiv FX Trading*, menjëherë sapo një gjë e tillë të jetë e mundur.

3. Bankat, në intervalin e kohës së përcaktuar për llogaritjen e fiksimit, publikojnë kuotimet standarde më të fundit në faqet e tyre në *Thomson Reuters Eikon*.

Neni 5

Koha e llogaritjes së fiksimit dhe marrja e informacionit

1. Si rregull, llogaritja e fiksimit bëhet çdo ditë pune nga DOM-i, në intervalin kohor 11:30–12:00.

2. Duke filluar nga ora 11:30, DOM-i verifikon nëse bankat kanë paraqitur në faqen e tyre në *Reuters* kuotimet standarde më të fundit, nëpërmjet identifikimit të datës dhe orës së vlefshmërisë së kurseve të këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan dhe euros, me të cilin ato janë të gatshme të tregtojnë në tregun ndërbankar.

3. Vlerat e kursit të këmbimit të euros dhe dollarit amerikan kundrejt lekut, të secilës prej bankave, si dhe vlerat e monedhave të listuara në nenin 6, pikat 5 dhe 6, të këtij udhëzimi kundrejt dollarit amerikan, merren nga një aplikacion i *Thomson Reuters Eikon*, i cili automatikisht regjistron këto vlera në momentin e llogaritjes së fiksimit.

Neni 6

Përpunimi i informacionit

1. Dollari amerikan është valuta e referencës. Kursi i këmbimit të lekut kundrejt valutave të tjera llogaritet në bazë të raporteve të valutave, me përjashtim të euros, me valutën e referencës në tregun ndërkombëtar.

2. Në fashën kohore të përcaktuar, DOM-i sigurohet që të përditësohen të dhënat automatike nga aplikacioni, i cili i rendit kurset sipas rendit zbritës, duke nisur nga vlera më e lartë. Pasi përjashton dy vlerat më të ulëta dhe të larta të këmbimit të dollarit amerikan dhe euros kundrejt lekut, llogaritet vlera mesatare e kuotimeve të mbetura për

të dyja këto monedha. Vlerat që përftohen përfaqësojnë fiksion e kursit të këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan dhe euros.

3. Paralelisht me llogaritjen e fiksit, sipas pikës 2 të këtij neni, llogaritet edhe mesatarja e kuotimeve në blerje dhe mesatarja e kuotimeve në shitje të bankave, për monedhat e euros dhe dollarit amerikan. Për përllogaritjen e këtyre mesatareve përdoret metoda e mesatares së thjeshtë aritmetike e të gjitha kuotimeve.

4. Me përfundimin e vlerës së fiksit të kursit të këmbimit të lekut kundrejt valutës së referencës si më sipër, llogariten raportet e këmbimit të lekut kundrejt valutave të tjera, sipas raporteve të tyre në tregun ndërkombëtar kundrejt dollarit amerikan në momentin e llogaritjes së fiksit.

5. Llogaritja e fiksit kryhet çdo ditë pune për: dollarin amerikan, euron, jenin japonez, paundin britanik, frangën zvicerane, dollarin australian, dollarin kanadez, koronën suedeze, koronën norvegjeze, koronën daneze, lirën turke, juanin kinez (*onshore*), juanin kinez (*offshore*) dhe njësinë monetare të Fondit Monetar Ndërkombëtar. Në çdo ditë pune llogaritet gjithashtu fiksi për këto metale të çmuara: ar (për 1 onc) dhe argjend (për 1 onc).

6. Me frekuencë 15 ditore, në ditën e mesit dhe të fundit të punës të çdo muaji, llogaritet fiksi për: leva bullgare, forinta hungareze, rubla ruse, kuna kroate, korona çeke dhe dinari maqedonas. Për llogaritjen e kursit zyrtar të këmbimit të të gjitha monedhave të përmendura në këtë pikë, si valutë reference përdoret kursi i dollarit amerikan me lekun.

7. Nëse gjykohet e nevojshme, si rezultat i zhvillimeve në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore, valutat për të cilat llogaritet fiksi me frekuencë ditore ose më të rrallë, mund të shtohen ose të pakësohen. Propozimi për shtimin ose pakësimin e monedhave bëhet nga DOM-i dhe miratohet nga Administratori Përgjegjës.

8. Në rastet kur pjesëmarrëse në procesin e fiksit janë më pak se 5 banka, siç parashikohet në nenin 3, pika 3, të këtij udhëzimi, fiksi llogaritet si mesatare e thjeshtë aritmetike e çmimeve në blerje dhe në shitje, pa përjashtuar dy vlerat më të ulëta dhe të larta të këmbimit të dollarit amerikan dhe euros kundrejt lekut.

Neni 7 Publikimi i fiksit

1. Banka e Shqipërisë llogarit dhe publikon fiksion, si dhe vlerën mesatare të çmimeve të blerjes (*bid price*) dhe të shitjes (*ask price*) për monedhat e euros dhe dollarit amerikan çdo ditë pune.

2. Me përfundimin e procesit të llogaritjes së kursit zyrtar të këmbimit, jo më vonë se ora 12:30, hidhen të dhënat e fiksit të ri të llogaritur, në faqen e Bankës së Shqipërisë në *Thomson Reuters Eikon*, në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë, si dhe në sistemin automatik që përdoret në Bankën e Shqipërisë.

3. Nëse, për arsye teknike, një gjë e tillë është e pamundur, informacioni jepet nëpërmjet telefonit, faksit ose postës elektronike, në përgjigje të kërkesave të të interesuarve. Njëkohësisht, DOM-i i dërgon të dhënat pranë departamenteve të Bankës së Shqipërisë, që janë të interesuara.

4. Për monedhën e euros dhe dollarit amerikan, Banka e Shqipërisë publikon vetëm në faqen e saj zyrtare të internetit edhe vlerën mesatare të çmimeve të blerjes (*bid price*) dhe të shitjes (*ask price*).

5. Të interesuarit njihen me kursin zyrtar të këmbimit në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë ose kontaktojnë me shkrim Bankën e Shqipërisë. Në varësi të llojit të informacionit të kërkuar, përgjigjja me shkrim e Bankës së Shqipërisë jepet përkatësisht nga:

a) DOM-i, në rast se informacioni i kërkuar ka lidhje me kurset ditore të monedhave të huaja ndaj lekut;

b) Departamenti i Statistikave Financiare, nëse informacioni i kërkuar lidhet me tregues të përpunuar, të tillë si: mesataret mujore e tremujore.

Neni 8

Ruajtja dhe arkivimi

DOM-i ruan të dhënat (faqet dhe bisedat në *Thomson Reuters Eikon*, mesazhet në *e-mail* etj.) për çdo proces të llogaritjes së fiksit në formë elektronike dhe në formë fizike, në përputhje me rregullat e Bankës së Shqipërisë për arkivimin e materialeve.

Neni 9

Veprimet e Bankës së Shqipërisë në rastet e moszbatimit të këtij udhëzimi

1. Në rast se banka/at e përzgjedhur, nuk kuoton kursin e këmbimit, sipas këtij udhëzimi, Guvernatori urdhëron bankën/at për vijimin normal të kuotimit në tregun valutor, në mbështetje të objektivit dytësor të Bankës së Shqipërisë për zhvillimin e sistemit të këmbimeve valutore.

2. Në rastet e mosrespektimit të kuotave ose tregtimit të limituar midis pjesëmarrësve, DOM-i propozon në Komitetin e Zbatimit të Këshillimit dhe Politikës Monetare për përjashtimin e bankës nga veprimet e ndërhyrjes së drejtpërdrejtë dhe me ankand, për një afat deri në 1 vit.

3. Rastet e mosrespektimit të kërkesave të udhëzimit, lidhur me komunikimin në kohën e caktuar dhe për sasi të standardizuara monitorohen çdo ditë, dhe kur ato janë të përsëritura më shumë se 3 herë brenda muajit nga e njëjta bankë, DOM-i informon me shkrim Drejtuesin Ekzekutiv të bankës përkatëse për mosrespektimin e këtyre kërkesave.

Neni 10

Forca madhore

Banka e Shqipërisë nuk mban përgjegjësi për vonesat në publikim apo mospublikim të fiksit, si dhe të vlerës mesatare të çmimeve të blerjes (*bid price*) dhe të shitjes (*ask price*) për monedhat e euros dhe dollarit amerikan, që vijnë nga ndërprerja e punës e shkaktuar nga forca madhore.

Neni 11

Të fundit

1. Me zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen DOM-i, Departamenti i Statistikave Financiare në Bankën e Shqipërisë dhe të gjitha bankat e përzgjedhura në procesin e llogaritjes së fiksit.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, shfuqizohet vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 66, datë 30.8.2006, “Për miratimin e udhëzimit ‘Mbi mënyrën e llogaritjes së fiksit të kursit të këmbimit të lekut në Bankën e Shqipërisë’”.

Ky udhëzim hyn në fuqi më datë 1 korrik 2021 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko